



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëria Stellantis N.V dhe shoqëria Wonderful Stars Pte.Ltd.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.403 prot., i AK, datë 07.09.2021 “Përqendrim ndërmjet Stellantis N.V, Fih Mobile Limited / JV”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me krijimin e një joint – venture me funksione të plota mes shoqërisë Stellantis N.V dhe shoqërisë Fih Mobile Limited.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për sipërmarrjen e përbashkët”, palët janë:

Pala 1: Stellantis N.V, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e listuar publikisht në bursë, e organizuar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: Aktivitet financiar.

Stellantis N.V është shoqëria mëmë e Grupit të shoqërive Stellantis dhe nuk ka filiale, degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet distributorëve të pavarura, palë të treta.

Stellantis është një shoqëri globale lider e prodhimit dhe shitjes së automjeteve.

Pala 2: Wonderful Stars Pte.Ltd, është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Singaporit, me objekt aktiviteti: shitja me shumicë të aparateve telefonikë dhe pajisje të tjera telekomunikacioni (p.sh. orë smart, kompjuter të veshur dhe libra elektronikë).

Wonderful Stars Pte.Ltd dhe Fih Mobile Limited, janë pjesë e Hon Hai Precision Industry Co.,Ltd, i cili është një prodhues global, lider i pjesëve dhe pajisjeve elektronike.

Pala 3: Fih Mobile Limited, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Ishujve Kajman. Fih Mobile Limited, është një shoqëri mbajtëse (holding company) investimesh kryesisht aktive në nivel ndërkombëtar në projektimin, zhvillimin, prodhimin, montimin dhe shërbimet që ofrohen pas shitjes për shoqëritë kompjuterike, shoqëritë e komunikimeve dhe pajisjeve elektronike të konsumatorëve.

Ndërmarrja e përbashkët (JV), Mobile Drive Netherlands B.V është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: Aktivitet financiar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin

10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.